



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0950

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj - Mexhuani si Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “RSM Company” Sh.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Kuvendi Komunal Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perëndimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1, me 25/01/2024, mori:

Vendim

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “RSM Company” SH.P.K. me nr. 2023/0950, e datës 27/11/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perëndimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “RSM Company” Sh.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 19.10.2023 Kuvendi Komunal Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perendimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1.

Ndërsa me datën 21.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “LD Construction SHPK & Ibrahim Kurrumeli B.I & Valdrini “SHPK.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 36,000.00€.

Me 23.11.2023 OE “RSM Company” Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar vendimin e datës 21.11.2023, me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues përkatësisht komisioni i vlerësimit konsideron se ka vepruar konform kërkesave dhe dëshmime të kërkuara në bazë të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe duke iu përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së. AK me këtë rast konsideron se për këtë aktivitet të prokurimit ka nxjerr vendim të drejtë, të arsyeshëm dhe meritore duke iu përmbajtur nenit 59 për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. GOE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesën e FDT-së sa i përket pajisjes së kërkuar.

Me 27.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “RSM Company” Sh.P.K me nr. 950/23 për lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perendimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “RSM Company” Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se : “Në Dosje të tenderit është kërkuar: Pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht tek kërkesat e makinerive: Pajisjet teknike që duhet t’i posedojë tenderuesi a. *Kamion me mekanizëm për largimin e bores (pllugun) me hedhes te kripës - min. 2 copë* b. *ngarkues i madh (lugë) dhe gërryese e shtresës se akullit- min. 1 copë*. Kurse GOE te shpallur fitues kanë paraqitur një listë të pajisjeve ku shihet se për pozicionin Gërryese e shtresës se akullit- min. 1 cope, nuk kanë paraqitur dëshmitë e kërkuara. Ky GOE ka paraqitur 2 grejderë qe nuk përkojnë me kërkesën e AK-së, pasi që siç dihet Grejderi është makineri qe përdoret për rrafshimin e dheut, edhe vete termi në gjuhën shqipe për këtë makineri është Rrafshues i dheut. Tek dokumentet qe kemi tërhequr gjatë qasjes se ofruar nga ana e AK-se, kemi vërejtur qe AK ka kërkuar sqarim pikërisht për këtë pikë. Nuk dihet se çfarë sqarimi kanë ofruar GOE te shpallur fitues, apo kanë dërguar makineri tjera jashtë listës se dorëzuar, por kjo nuk duhej pranuar si e mirëqenë pasi që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, konkretisht me Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve – nënpika 2 që thotë: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. AK është dashur të pranoj sqarim vetëm lidhur me makineritë e dorëzuara ne ditën e ofertimit. Dhe në materialin tenderues makineritë e dorëzuara nuk plotësojnë kërkesat e DT dhe Njoftimin për Kontrate, pasi që në asnjë rast një grejder nuk është freze apo gërryese e bores/akullit, dhe rrjedhimisht s’mund të kryej funksionin e frezës. Pra në këtë rast GOE i shpallur fitues nuk ka paraqitur dëshmi te mjaftueshme sipas kërkesave te DT, pasi qe Grejderi nuk është makineri qe përdoret për gërryerjen e shtresës se akullit, por për këtë përdoret gërryesja ose freza e akullit/bores, ashtu siç i kemi dorëzuar ne si OE. Ne këtë rast AK është dashur që të eliminoj si OE të papërgjegjshëm dhe të shpall fitues kompaninë RSM Company pasi që jemi i vetmi ofertues i përgjegjshëm duke pasur parasysh që OE tjetër i radhitur ka bërë tejkalim të vlerës së parashikuar për këtë projekt.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE : “RSM Company” Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 59 të LPP-së duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, te kthehet lenda në rivlerësim dhe te shpallet fitues RSM Company

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 950/23, ndërsa me datë 06.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2023/0950 me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar “AK nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit pasi qe Ak ka Rekomanduar OE me çmim me te lire, ndërsa pajisja greder kryen funksionin e pastrimit te bores” ndërsa OE nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Lidhur me pretendimet e OE : “RSM Company” Sh.P.K ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0950 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjate sezonit dimëror pjesa larte perëndimore ne Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me nr. të prokurimit: "613-23-11429-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 19.10.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 09.11.2023, si dhe vendimi B58 është publikuar me datë 21.11.2023, të cilët kanë rekomanduar OE “LD Construction SHPK & Ibrahim Kurrumeli B.I & Valdrini “SHPK, ndërsa OE ankuesin e shpallë të pasuksesshëm. OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 04.12.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar që AK ka shkelë ligjin e prokurimit publik përkatësisht nenin 1 dhe nenin 59, sepse OE i rekomanduar është i pa përgjegjshëm sepse nuk posedon pajisjet.”

Konstatimi i parë (I): “Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet lista e pajisjeve, në të cilën OE i rekomanduar ka ofruar pajisje më tepër se sa kërkesa. Sa i përket grejderit, sipas sqarimeve të OE të rekomanduarit, i njëjti ka sjellë si pajisje shtesë për raste nëse ka nevojë, përndryshe OE i rekomanduar ka ofruar në vend të dy kamion për largim të borës, ka ofruar tre kamion me marrëveshje dhe me dëshmi librezat, për kërkesën e dytë ngarkues i madh(lugë) është kërkuar 1 i njëjti ka ofruar 2 lugë me marrëveshje dhe dëshmi, gërryesen kërkesa ka qenë një kurse i njëjti ka ofruar 2 makina Grejder me marrëveshje dhe dëshmi, kurse sqarimet e kërkuar nga AK janë për ngarkuesin lugë për të cilën OE i rekomanduar ka sqaruar dhe të njëjtat dokumente ka poseduar po ashtu në ofertë, mirëpo vlen të theksohet se për këtë pajisje fatura dhe transferi kanë dallime ne datë, ku transferi bankar është me datë më të hershme se sa fatura e lëshuar, e cila konsideroj se AK duhet ta sqaroj se a është fjala për të njëjtën makineri. Kurse sa i përket kërkesës së AK-së, lidhur me pajisjen nr.3 Gërryese e shtresës së akullit, OE i rekomanduar ka sjellë dy makina, Grejderi Faun F 105 në posedim të Valdrini SHPK (antari i konzorciumit) dhe O&K F106A, të cilat sipas hulumtimit në internet me nr. F105 Faun rezultojnë se janë këto lloje (provë: foto) Kurse, gërryesja e akullit rezulton të jetë sikurse ne foton e bashkangjitur (prove: foto). Si përfundim, meqenëse në listën e OE të rekomanduarit dhe si dëshmi dokumentet nuk përkojnë me njëra tjetrën, atëherë rekomandoj AK-në që këtë aktivitet të prokurimit ta kthej në rivlerësim ku procesin e rivlerësimit ta zhvilloj konform dispozitave ligjore të LPP-së, për faktin se sa i përket lugës ngarkuese ti verifikoj edhe njëherë dokumentet, kurse grejderi të sqarohet se a i përmbushë kërkesat e AK-së, pasi që AK në Dosje të Tenderit nuk ka saktësuar qartë asnjërën pajisje. Pra, kamionët a duhet të posedojnë dëshmi që kanë pajisjen e bashkangjitur për hedhjen e kripës, luga po ashtu a duhet të jetë e ndarë, si dhe gërryesja si duhet të jetë!”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perëndimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertës shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të anulohet vendimi i AK i datës 21.11.2023, dhe aktiviteti i prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perendimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1 të kthehet në rivlerësim. Andaj kërkohet nga AK që për këtë aktivitet të prokurimit gjatë rivlerësimit, të veproj konform dispozitave ligjore të LPP-së, sa i përket lugës ngarkuese ti verifikoj edhe njëherë dokumentet, kurse grejderi të sqarohet se a i përmbushë kërkesat e AK-së, pasi që AK “Në Dosje të tenderit është kërkuar: Pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht tek kërkesat e makinerive: Pajisjet teknike që duhet t’i posedojë tenderuesi a. Kamion me mekanizëm për largimin e bores (pllugun) me hedhes te kripës - min. 2 copë b. ngarkues i madh (lugë) dhe gërryese e shtresës se akullit- min. 1 copë. Kurse GOE te shpallur fitues kanë paraqitur një listë të pajisjeve ku shihet se për pozicionin Gërryese e shtresës se akullit- min. 1 cope, nuk kanë paraqitur dëshmitë e kërkuara, por ka prezantuar vetëm dy greider të cilës parimisht sipas gjykmit të këtij paneli nuk përkojnë me kërkesën e vendosur tek pika b gërryese e shtresës se akullit- min. 1 copë, megjithatë paneli vlerëson të sqarohet edhe një herë nga ana e komisionit profesional kjo çështje kontetsuese, kurse Paneli sqaron për AK që njehta vlerësimin duhet ta bëjë gjithnjë bazuar në kërkesat e përcaktuara në DT dhe në LPP respektivish nenin 59.4 i cili përcakton se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Duhet shpjeguar në këtë rast po ashtu se, mendimi i një eksperti nuk krijon efekte detyruese për organin vendimmarrës dhe së këndejmi Paneli ka shprehur mendimin e pavarur të tij në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 104 të LPP, përderisa vlerat provuese një raporti rezultojnë nga administrimi, shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha fakteve dhe provave përkitazi me veprimet dhe rrjedhën e procesit të prokurimit dhe kërkesat e legjislacionit, të cilat Paneli i vlerësoi mbi bazën e gjykimit të pavarur të tij/sajë, sqaron se autoritet kontraktuese duhet të ofrojnë shembullin e praktikave të mira dhe në kontekstin e vlerësimit dhe verifikimit të dëshmimeve të ofruara nga ankuesi në këtë rast si ofertues me çmim më të ulët në harmoni me nenin 6,7, 52.7,59,60,69 dhe 72 të LPP, po ashtu të sigurojnë që fondet publike do të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihen në paragrafët përkatës të nenit 1 të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - RSM Company SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: